**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarina Izborna Komisija
Central Election Commission
10 -12- 2020
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 1348/2020

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2, nenin 103.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 10.12.2020, nxjerrë këtë:

## VENDIM

**Për Asgjësimin/Shkatërrimin e Materialit Zgjedhor Sipas Aktgjykimeve të Plotëfuqishme**

I. Miratohet asgjësimi/shkatërrimi i materialit zgjedhor, sipas aktgjykimeve të plotëfuqishme, i cili është ruajtur në depo të KQZ-së, me kërkesën e organeve të drejtësisë.

II. Lista e vendvotimeve sipas aktgjykimeve të plotëfuqishme si në pikën I të këtij vendimi, që do të asgjësohen/shkatërrohen është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III. Obligohet Sekretariati që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

KQZ, pas pranimit të aktgjykimeve të plotëfuqishme nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka bërë regjistrimin e aktgjykimeve të plotëfuqishme për secilën komunë, qender të votimit, vendvotim si dhe për vitin zgjedhor.

Materialet e ruajtura në depot e KQZ-së, nuk mund të shërbejnë më si provë në ndonjë çështje penale, të njëjtat u vendos që të asgjësohen/shkatërrohen, pasi që në çështjet penale për të cilat janë filluar, zhvilluar hetime dhe procedur gjyqësore, dhe pas konfirmimit nga organet e drejtësisë, gjykatat tashmë kanë vendosur dhe kanë shpallur akgjykim, dhe sipas procedurave gjyqsore aktgjykimet janë të plotëfuqishme. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 10.12.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

**Valdete Daka**